

AKT THEMELIMI
SHOQËRIA TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"IBIMPEX" SHPK.

Sot në Tiranë, më 01.06.2023, bazuar në legjislacionin shqiptar, me vullnetin tonë të lirë, jemi shprehur në nënshkrimin si ortakë themelues dhe deklarojmë se kemi përpiluar si më poshtë Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**IBIMPEX**" SHPK.

Ne ortakët,

1. **Alida IBI**, e datëlindjes 20.09.1976, lindur në Pogradec dhe banuese në Tiranë në adresën: Rruga Frederik Shiroka, Nd.10, H,3, Ap.6 Njësia administrative Nr.7, e identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me numër personal H65920030K, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar
2. **Alesia IBI**, e datëlindjes 13.03.2002, lindur në Itali dhe banuese në Tiranë në adresën: Rruga Frederik Shiroka, Nd.10, H,3, Ap.6 Njësia administrative Nr.7, e identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me numër personal K25313021D, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar
3. **Laura IBI**, e datëlindjes 10.08.1998 lindur në Pogradec dhe banuese në Tiranë në adresën: Rruga Frederik Shiroka, Nd.10, H,3, Ap.6 Njësia administrative Nr.7e identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me numër personal J85810033I madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar

THEMELIMI

Neni 1

Themelohet Shoqëria tregtare "IBIMPEX" SHPK, e cila do të nënshtrohet legjislacionit të Republikës së Shqipërisë në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë.

SELIA E SHOQËRISË

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare "IBIMPEX" SHPK do të jetë në adresën: **Rruga Kavajes, Zona Kadastrale 8240, Volum 3, faqe 131, Nr. Pasurie 2/156.**

Neni 3

Shoqëria tregtare mund ta ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë Shtetit.

Shoqëria mund të krijojë seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Njësitë vartëse të shoqërisë jashtë shtetit do të krijohen nëse kjo e drejtë parashikohet dhe lejohet nga legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

OBJEKTI I SHOQËRISË

Neni 4

Shoqëria tregtare krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj tregtar me objekt: **Import-eksport, tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve industriale dhe ushqimorë. Shitje me shumicë dhe pakicë e veshjeve, rroba dhe këpucë të përdorura. Transport ndërkombëtar mallrash për vete dhe për të tretë.**

Neni 5

Me vendim të organeve vendimarrëse të shoqërisë, shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar edhe në drejtime të tjera, kur ato janë në interes së mbarëvajtjes së aktivitetit të shoqërisë.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (Njëqindmijë lekë), kapital i cili formohet dhe do të jetë në vlerë monetare nga ortakët si më poshtë:

1. Alida Ibi, 1 kuotë me vlerën 50,000 lekë ose 50 % të kuotës në kapitalin e shoqërisë,



2. Alesia Ibi, 1 kuotë me vlerën 25,000 lekë ose 25 % të kuotës në kapitalin e shoqërisë,

3. Laura Ibi, 1 kuotë me vlerën 25,000 lekë ose 25 % të kuotës në kapitalin e shoqërisë.

Shuma e kapitalit themeltar do të depozitohet në një llogari bankare në emër të shoqërisë në një prej bankave të nivelit të dytë që zhvillojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 7

Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë është pa afat dhe fillon nga data e regjistrimit të saj si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve ka të drejtë të ndryshojë me vendim kohëzgjatjen e ushtrimit të veprimtarisë dhe ky vendim depozitohet menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

DREJTIMI I SHOQËRISË

Neni 8

Veprimtaria e shoqërisë tregtare "IBIMPEX" SHPK do të drejtohet nga Administratori i saj z. Lefter IBI nëpërmjet letërnjoftimit me numër personal: G80328045B, i cili zgjidhet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhje.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve ka të drejtë të emërojë një administrator tjetër, nëse e gykon të nevojshme.

Neni 9

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të punësojë persona të ndryshëm në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së shoqërisë

Neni 10

Shoqëria tregtare "IBIMPEX" SHPK do të ketë vulën e saj, në të cilën shkruhet emërtimi i shoqërisë.


Neni 11

Shoqëria tregtare "IBIMPEX" SHPK deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi.


Ky akt themelimi u përpilua në gjuhën shqipe dhe miratohet prej Ortakëve duke u nënshkruar si më poshtë:

THEMELUESIT E SHOQËRISË TREGTARE "IBIMPEX" SHPK

ORTAKU
Alida IBI



ORTAKU
Alesia IBI



ORTAKU
Laura IBI

